



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË KORÇË, TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "G-99" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë, të paraqitura nga Partia "G-99", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma a, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "G-99", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia "G-99", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia "G-99" ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.



**Nr. 430 i Vendimit**

**Data 16.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të Partisë "G-99", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në mbledhjen e datës 16.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "G-99" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Nuk është respektuar kuota gjinore në listën shumemërore Model 10 K;
2. Deklarimi për vendet sipas kuotës gjinore Modeli 09 K;
3. Deklarata e kandidatit me nr.rendor 1 dhe 5.
4. Dokumenti identifikimit të kandidatëve me nr.rendor 1,2,3,12,13,14,15,16,17.

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuara, nga "Partia G-99".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

#### **V E N D O S I:**

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë Këshilli të Bashkisë Korçë, të Partisë "G-99", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 430 i Vendimit**

**Data 16.05.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të Partisë "G-99", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019